

Lejet e ndërtimit

Tremujori IV, 2022

Tiranë, më 28 Shkurt 2023: Në tremujorin e katërt 2022 janë miratuar gjithsej 415 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 356 leje të miratuara në tremujorin e katërt 2021, duke shënuar një rritje prej 16,6 % (tab.2).


Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja, në tremujorin e katërt 2022, është 555.779 m², nga 608.870 m² miratuar në tremujorin e katërt 2021, duke shënuar një ulje prej 8,7 % (tab.3).

Në tremujorin e katërt 2022, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 26.6 miliardë lekë, nga 27,0 miliardë lekë miratuar në tremujorin e katërt 2021, duke shënuar një rënie prej 1,7 % (tab.4).

Gjatë vitit 2022, janë miratuar gjithsej 1.420 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 1.396 leje të miratuara në vitin 2021, duke shënuar një rritje prej 1,7 %.

Gjatë vitit 2022, sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja është 2.667.497 m², nga 2.316.709 m² miratuar në vitin 2021, duke shënuar një rritje prej 15,1 %. Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 113 miliardë lekë në vitin 2022, nga 99.2 miliardë lekë miratuar gjatë vitit 2021, duke shënuar një rritje prej 14 %.

Fig. 1 Struktura e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit, 2022 (%)



Tab.1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, T4 - 2022

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m ²	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
Gjithsej			20.049.229	6.523.154
I. Ndërtesa	415	555.779	18.885.305	2.331.486
1.Ndërtime për banim (rezidente)	343	407.107	14.069.965	668.363
a. Me një kat	166	16.194	588.113	81.331
b. Me dy kate	110	21.789	854.779	131.328
c. Me tre ose më shumë kate	55	215.660	7.443.367	436.962
d. Rezidenca për komunitetet	12	153.464	5.183.706	18.742
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	72	148.672	4.815.340	1.663.123
a. Hotele dhe të ngjashme	17	50.860	1.679.351	170.875
b. Ndërtesa për zyra	0	0	0	337.965
c. Ndërtesa tregtare	16	8.232	240.618	22.627
d. Ndërtesa industriale	18	73.687	1.954.950	74.845
e. Ndërtesa të tjera	21	15.893	940.421	1.056.811
II. Punime Inxhinierike			1.163.924	4.191.668
1. Infrastruktura e transportit; Rrugë e autostrada			531.205	975.171
2. Linjat e ujësjellësve,elektrike dhe telekomunikacionit			27.125	2.777.135
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			0	0
4. Punime të tjera inxhinierike			605.594	439.362

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.2 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	IV - 21	I - 22	II - 22	III - 22	IV - 22
Shqipëria	356	397	339	269	415
Berat	13	7	2	16	5
Dibër	1	5	4	4	3
Durrës	82	84	90	82	189
Elbasan	41	24	31	16	23
Fier	33	48	17	13	22
Gjirokastër	4	6	4	5	1
Korçë	29	20	38	20	34
Kukës	6	4	8	0	0
Lezhë	17	45	12	17	21
Shkodër	7	13	13	7	5
Tiranë	99	112	95	86	89
Vlorë	24	29	25	3	23

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për numrin e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.3 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	IV - 21	I - 22	II - 22	III - 22	IV - 22
Shqipëria	608.870	1.031.088	661.945	418.685	555.779
Berat	1.521	1.988	745	12.165	867
Dibër	200	853	656	690	1.632
Durrës	68.815	90.347	169.038	96.822	79.491
Elbasan	14.770	6.452	7.504	7.031	15.688
Fier	8.646	18.144	20.390	2.259	9.891
Gjirokastër	9.499	6.777	951	5.263	109
Korçë	29.666	7.949	18.657	3.869	24.955
Kukës	22.322	2.313	3.184	0	0
Lezhë	10.368	26.745	11.034	13.338	12.926
Shkodër	1.620	18.243	8.365	1.587	7.454
Tiranë	398.154	800.375	388.073	271.611	348.310
Vlorë	43.289	50.902	33.348	4.050	54.456

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për sipërfaqen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.4 Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Qarqet	IV - 21	I - 22	II - 22	III - 22	IV - 22
Shqipëria	27.031.148	39.035.400	25.899.327	21.633.005	26.572.383
Berat	86.931	89.593	25.414	594.785	257.249
Dibër	15.151	46.728	88.533	14.706	1.342.625
Durrës	3.568.697	5.636.376	8.693.707	5.784.690	2.691.797
Elbasan	488.766	297.295	337.817	2.749.309	3.830.507
Fier	647.614	924.123	1.195.110	752.573	816.833
Gjirokastër	435.896	165.970	148.089	76.029	12.170
Korçë	2.725.823	275.183	146.438	190.842	1.451.995
Kukës	141.148	114.371	289.679	0	11.936
Lezhë	3.457.378	996.048	627.446	1.642.418	909.183
Shkodër	237.561	106.472	176.815	42.606	253.444
Tiranë	13.625.271	28.747.245	13.057.514	9.380.465	12.156.725
Vlorë	1.600.912	1.635.996	1.112.765	404.582	2.837.919

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Vlera e përafërt përfshin vlerën e ndërtimeve të reja dhe rikonstruksioneve.

Metodologjia

Lejet e ndërtimit është një publikim me frekuencë tremujore i cili ka për qëllim të paraqesë informacion mbi lejet e ndërtimit të miratuara për ndërtesa dhe punimeve inxhinierike në nivel qarku dhe vendi. Informacioni statistikor rreth lejeve të ndërtimit të miratuara është një tregues afatshkurtër i cili paraqet zhvillimin e sektorit të ndërtimit në periudhën pasardhëse.

Treguesit kryesorë të lejeve të ndërtimit të miratuara të cilat paraqiten në këtë publikim janë:

- Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja;
- Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja;
- Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike.

Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet nga zyrat rajonale të INSTAT në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse.

Përkufizime

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Sipërfaqja është hapësira gjithsej në metra katrorë ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.

Punime inxhinierike janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

Klienti është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.